-66

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETARE I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE

# L E J E

## PER PERDORIM REZERVE UJORE
## PER PRODHIM ENERGJIE
## Nr.13 , date 10.06.2013.

**A- Emri dhe adresa e marresit te "Lejes per Perdorim te Rezerves Ujore".**
Shoqerise **" TEODORI 2003 " sh.a.**
me administrator z. Faik Teodori me adrese Rruga Ibrahim Rugova Tirane.

**B- Objekti i lejes dhe specifikimet e tij.**
Burimi ujor, Liqeni Zi .
Baseni Ujembledhes Drin – Bune, Rrethi Buqize. Qarku Diber.
Burimi ujor eshte ne pronesi shtetrore.
Hidrocentrali **" Ternove-Valikardhe ".**
Veprat e marrjes do te ndertohen ne kuoten:+1644.9m,
Ndertesa centralit do te ndertohet ne kuoten + 643.05 m.
Prurja mesatare Q= 1.1 m3/sek. Subjekti do shfrytezoje Q= 1 m3/sek.

**C- Aktiviteti per te cilin do te perdoret kjo rezerve ujore eshte:**
Prodhim energjie , me kusht qe te mos kufizohet furnizimi me uje te pijshem dhe nevojave te bujqesise ne zone.

**D- Kjo leje eshte e vlefshme deri me date: 09.06.2043**. Marresi i kesaj leje eshte i detyruar te plotesoje te gjitha kushtet qe i bashkengjiten kesaj leje dhe vendimit te K.B.U. Drin-Bune nr. 13, dt.10.06.2013.

**K R Y E T A R E**

**KESHILLIT TE BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE**
**Sekretari i Pergjithshem i Prefektures**

**Fatbardh Sheqi**

KESHILLI KOMBETAR I UJIT
KESHILLI I BASENIT DRIN-BUNE

## KJO LEJE PERDORIMI JEPET ME KETO KUSHTE:

1. Te respektohet qellimi per te cilin kerkohet ky autorizim.
2. Te respektohen kushtet higjeno-sanitare dhe te mbrojtjes se mjedisit perreth.
3. Perdoruesi i ujit eshte i detyruar te vendose mates uji me shpenzimet e veta, sipas rregullave qe vendosin autoritetet e ujit, qe japin lejen.
4. Kur uji perdoret si produkt si ushqimor, procedurat e prodhimit duhet te jene konform rregullave te Ministrise se Bujqesise dhe Ushqimit.
5. Burimi ujor te shfrytezohet nga zoteruasi i lejes. Leja ndalohet t'i transferohet nje subjekti tjeter.
6. Te mos kryhen veprime qe sjellindrejtperdrejt ose si pasoje, demtimin e burimit ujor.
7. te mos pengohet kontrolli i shfrytezimit te ujit qe kryhet nga Agjencite e Ujit te Keshillave te Baseneve Ujembledhes, nga Sekretariati Teknik i KKU, ose persona te autorizuar prej tyre.
8. Per shkeljen e kushteve ligjore te kesaj leje, do te merren masa ne perputhje me Kreun XVI te ligjit nr. 8093, dt. 21.03.1996 "Per rezervat ujore".
9. Zoteruesi i lejes paguan per shpenzimet administrative dhe tarifen per ujin e shfrytezuar, bazuar ne vendimet perkatese te Keshilit te Ministrave.

## NDRYSHIMI OSE ANULLIMI I LEJES:

Kjo leje mund te ndryshohet pjeserisht ose te anullohet plotesisht, [ara mbarimit te afatit te percaktuar, kur:

1. Perfituesi i lejes shkel njerin nga kushtet e parashikuara me siper.
2. Organi kompetent per nxjerrjen e lejes ben azhornimet perkatese lidhur me burimin konform ndryshimit t planeve te rezervave ujore, ndryshim i cili prek dhe burimin ujor, objekt te kesaj leje.
3. Kushtet e dhenies se lejes kane ndryshuar.
4. Burimi ujor eshte drejt shterimit.
5. Kur aktiviteti qe ushtrohet, bazuar ne lejen e dhene, eshte shkak i ndotjes se burimit ose mjedisit.

Ne qofte se per shkak te forcave madhore ndodhin ndyshime ne prurjen, cilesine, kufijte e burimit, etj dhe k ndyshime sjellin pamundesine e perdorimit te tij nga zoteruesi i lejes, ky i fundit ka te drejte t'i drejtohet org kompetent qe i ka dhene lejen, per ta anulluar ate.